



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 82-të, të mbajtur më datë 14.02.2023 morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-4134/1 datë 30.10.2021, e krijuar me vetiniciativë, për shkeljen e dispozitave të nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga _____, anëtar i Bordit Drejtues i _____, NDËRPRITET.

Konstatohet se pas kundërvajtjes së lëshuar me urdhërpagesë me numër 08-5510/2 të datës 02.06.2022, është vepruar nga ana e të emëruarit, përkatësisht në të është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda e regjistruar sipas numrit 08-4134/1 të datës 30.10.2021 është formuar me vetiniciativë.

KSHPK-ja, nga kontrolli në Gazetën Zyrtare të RMV-së numër 191/2021, ka konstatuar se _____ me Vendimin nr. 14 -8593/1 të datës 30.07.2021 është emëruar në detyrën anëtar i bordit drejtues të _____

dhe në afatin e paraparë ligjor pas emërimit në funksionin nuk ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK.

Për sa më sipër, KSHPK-ja i ka lëshuar personit të përmendur një urdhërpagesë kundërvajtëse nr. 08-5510/2 të datës 02.06.2022, për shkelje të kryer nga neni 82 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i dënueshëm sipas neni 109 të të njëjtit ligj.

Nga ana e personit të emëruar në afatin e përcaktuar ligjor është vepruar sipas urdhërpagesës kundërvajtëse, përkatësisht është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar në të.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti:A.Ç.

Miratoi: Mr. Vladimir Georgiev anëtar në KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
NËNKRYETARE,
Katica Nikolovska**